

E K S T R A K T
NGA PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË PARË TE KUVENDIT TE SHOQATES PER
DEME TE LUFTES ‘N.Z. NE SKENDEAJ MBAJTUR MË
29. 03. 2010

Mbledhja është mbajtur ne sallën e Asamblesë Komunale në ndërtesën e ish TMK-së tek Pishat duke filluar nga ora 13,00.

Procesverbalin e ka mbajtur z.Hamdi Bislimi, zyrtar juridik i shoqatës për dëme te luftës.

Mbledhjen e kryesoi z.Jahir Bejta përfaqësues i shoqatës për dëme te luftës “Ngritja e Zërit” ne Skenderaj. Ai mbledhjen e deklaroi të hapur dhe konfirmoi se në mbledhje morën pjesë mbi 2/3 e anëtarëve te Kuvendit .

Për këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i d i t ë s :

1. Ekspoze nga kryesuesi i shoqatës përkitazi me punën e deritanishme te shoqatës dhe sfidat
 2. Shqyrtimi i propozim Rregullores së Punës për OJQ “Ngritja e Zërit” në Skenderaj,
 3. Shqyrtimi i propozim Planit te Veprimit te shoqatës për dëme te luftës për vitin 2010
 4. Shqyrtimi i Raportit të Punës së shoqatës për dëme te luftës për vitin 2009
 5. Zgjedhja e përfaqësuesit (kryetarit) te shoqatës
 6. Zgjedhja e Kryesisë së Kuvendit të shoqatës për dëme te luftës
- Kryesuesi konstatoi miratimin e rendit te ditës nga ana e anëtarëve te Kuvendit .

I

Jahir Bejta, kryesues dha një ekspoze lidhur me historikun e subjektit, motivimin për regjistrimin e shoqatës, shtimin e interesimit te qytetarëve për ngritje te padisë përkitazi më kompensimin e demit te shkaktuar nga agresori serb, sfidat për realizimin e objektivit e sidomos angazhimin për zgjedhjen e formës së mundshme për sigurimin e mjeteve financiare te domosdoshme për kompensimin modest te stafit te rregullt në zyrë.

II

Lidhur me propozim Rregulloren ë Punës për OJQ “Ngritja e Zërit” në Skenderaj e cila paraprkisht u është shpërnda anëtarëve te Kuvendit për shqyrtim me datën 25.02.2010 arsyetimin e dha Jahir Bejta . Ne bazë te votave, kryesuesi konstatoi miratimin e Rregullores së Punës për OJQ “Ngritja e Zërit” në Skenderaj.

III

Lidhur me propozim Planin e Veprimit te shoqatës për dëme te luftës për vitin 2010 i cili paraprkisht u është shpërnda anëtarëve te Kuvendit për shqyrtim me datën 25.02.2010 arsyetimin e dha Jahir Bejta .
Ne bazë te votave, kryesuesi konstatoi miratimin e Planit te Veprimit te shoqatës për dëme te luftës për vitin 2010

IV

Lidhur me Raportit e Punës së shoqatës për dëme te luftës për vitin 2009, arsyetimin e dha Jahir Bejta dhe hapi diskutimin ne diskutim.

Ne diskutim morën pjesë: Kadri Osaj, Brahim Xhaka, Nebih Ferizi, Hidajete Beqiri, Qerime Koci, Beqir Xhinovci, Bahtir Demiri dhe Haki Kadriu.

Ndërsa Qefsere Dauti dhe Shaqir Bejta juristë të diplomuar u deklaruan për punë vullnetare rreth hartimit të padive. Deklarimi për punë vullnetare u mirëprit nga ana e te pranishmëve ndërsa falënderim i veçantë ju bë nga ana e kryesuesit.

Ne bazë të votave, kryesuesi konstatoi miratimin e Raportit e Punës së shoqatës për dëme të luftës për vitin 2009

V

Nga deklarimi unanim i anëtarëve të Kuvendit, kryesuesi konstatoi se për përfaqësues (kryetar) të shoqatës për dëme të luftës “Ngritja e Zërit” në Skenderaj u zgjodh Jahir Bejta jurist i diplomuar i cili e ka përfaqësuar shoqatën deri në konstituivin e Kuvendit të Shoqatës, në mandat prej 4 vjetësh nga dita e zgjedhjes.

VI


Pas arsytimit të dhënë nga Jahir Bejta lidhur me punën e aktivistëve për themelimin e shoqatës për dëme të luftës, aktivitetin e veteranëve të luftës dhe veprimtarëve tjerë Kuvendi unanimisht e zgjodhi Kryesin e Shoqatës në përbërjen si në vijim:

1. Jahir Bejta nga Skenderaj
2. Kadri Osaj nga Klina e Epërme
3. Bekim Veliu nga Skenderaj
4. Hysni Ngucati nga Morina
5. Haki Aruqi nga Rezalla
6. Nebih Ferizi nga Skenderaj
7. Hajriz Loshi nga Skenderaj
8. Kajtaz Murati nga Plluzhina
9. Hidajete Beqiri nga Skenderaj
10. Hamdi Bislimi nga Skenderaj
11. Brahim Xhaka nga Vushtrria
12. Qerime Koci nga Skenderaj
13. Qefsere Dauti nga Runiku
14. Abedin Rrecaj nga Llausha dhe
15. Bahtir Geci nga Llausha

Kryesia në përbërje si më lart u zgjodh po ashtu në mandat prej 4 vjetësh duke llogaritur nga dita e zgjedhjes.

Më këtë Kuvendi përfundoi punimet në ora 15.00

Procesmbajtësi,
Hamdi Bislimi



Kryesuesi,
Jahir Bejta

